

**STATUTI i SHOQERISE TREGTARE  
"ORCHIDE TIRANA" sh.p.k**



**FORMIMI**

**Neni 1**

Sot ne Tirane ne daten 07.10.2021 perpara meje Noteres Gentiana Brati ,Anetare e Dhomes se Noterise Tirane, me adrese Rr" Gjergj Fishta", kulla nr 9, kati 1, në mbeshtetje te legjislacionit shqiptar respektivisht Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", dhe Ligjit 9723 dt.03/05/2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", u paraqiten dhe nënshkruan me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë Ortakët e Shoqërisë "ORCHIDE TIRANA" sh.p.k , dhe konkretisht;

Z. NAIM NISHORI atësia Milaim dhe amësia Fatime i dtl. 06.05.1972, lindur dhe banues në Kosovë , mbajtës i id kosovare me nr 1014063, **zotërues i vlerës prej 90 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë**

Z. ARJAN MELONASHI , atësia Elise, amësia Afërdita, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Ali Demi; Nd. 157; H. 1; Ap. 3; Njësia Administrative Nr. 1; Tiranë 1; 0000; Tiranë, lindur më 29/07/1961, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031707717 dhe nr. personal G10729017G, **zotërues i vlerës prej 10 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë**

**BAZA LIGJORE: L I G J I Nr. 9901, datë 14.4.2008 " PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE"**

Sipas Aktit të Themelimit të nënshkruar prej tyre në datën 07.10.2021 vendosën të krijojnë këtë shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar;

**SELIA**

**Neni 2**

Selia e Shoqërisë Tregtare "ORCHIDE TIRANA" shpk është në adresën Rruga "Hasan Sufa", pall 2. Shk 2, ap. 33, Tiranë . Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Per kete ajo mund te hape edhe seli te tjera operative, filiale, perfaqesi dhe agjenci ne te gjithë territorin e R.SH., si dhe jashte saj, ne perputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

**KOHEZGJATJA**

**Neni 3**

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e Shoqerise Tregtare "ORCHIDE TIRANA" shpk eshte e pakufizuar. Ajo mund te shperbehet ne cdo moment, sipas vendimeve te marra nga Asambleja e Ortakeve.

**Neni 4**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

1. Agjensi Imobiliare, shërbime të të gjithë llojeve dhe shërbimeve , konform legjislacionit aktual shqiptar.
2. Kryerja e operacioneve me pasuri të palujtëshme: blerje, shitje, marrje dhe dhënie me qira e në huapërdorje ose në çfardo lloj forme tjetër të pasurive të palujtëshme në funksion të realizimit të qëllimeve shoqërore si dhe sipërmarrje të ndryshme, në përputhje me kërkesat që burojnë nga ligjet në fuqi.

3. Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave shoqërore mund të marrë përsipër si direkt ashtu edhe indirekt, pjesmarrje në fitime e pjesmarrje në shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog ose të lidhur me të tyren.
4. Të krijojë, blejë , financojë, investojë, të hyjë në marrëdhënie të ndryshme me të tretë t, të kryejë sipërmarrje dhe projekte, të ofrojë shërbime dhe asistencë të të gjitha llojeve personave fizike dhe juridike, përfshi shërbimet menaxhuese, konsulence, planifikuese, këshilluese, financiare, investuese, teknike, administrative.
5. Shoqëria kryen çdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektit të saj, duke përfshirë edhe pjesmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndermarrje të tjera.

#### Neni 5

#### TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Ortakët kanë këto të drejta kryesore:

- të administrojnë aktivitetin e shoqërisë në përputhje me Statutin dhe Aktin Themelues;
- të marrin pjesë në fitimet e çfarëdo forme e sasi të aktivitetit të Shoqërisë, të parashikuara nga Akti themelues e Statuti i Shoqërisë.;
- të marrin në çdo moment dokumente, si raporti i administrimit, inventare e llogari vjetore, për tre vitet e fundit financiar.
- të terhiqet nga Shoqëria, duke ia ofruar kuotën e vet me përparësi ortakëve të tjerë të shoqërisë. Në mungesë të ushtrimit të së drejtës së parblerjes nga ana e ortakëve të tjerë, kuota mund t'iu kalojë të tjerëve, sipas kushteve e afateve të parashikuara në nenin 7 të Aktit Themelues dhe në nenin 9 të këtij Statuti.

#### Neni 6

Ortakët kanë këto detyrime kryesore:

- të depozitojnë kuotën e tyre fillestare të nevojshme si dhe ato suplementare, në përputhje me Statutin dhe Aktin Themelues;
- të marrin pjesë në administrimin e Shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë;
- t'iu japin Shoqërisë të dhenat e nevojshme për arritjen e të gjitha objektivave të qenesishme për aktivitetin e saj;
- të përmbushin të gjitha detyrat për realizimin e objektivave dhe funksioneve të shoqërisë.

#### Neni 7

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, objektin e shoqërisë, kapitalin, kohe zgjatjen etj, sipas vendimeve të marra nga vetë ortakët në mbledhjen e Asamblesë.

#### Neni 8

#### KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i Shoqërisë Tregtare "ORCHIDE TIRANA" shpk është prej 100 000 leke.( një qindmijë leke) i formuar nga Kapitalit themeltar i Ortakëve të shoqërisë, në vlerën prej 2 kuotash i formuar si më poshtë:

Z. NAIM NISHORI atësia Milaim dhe amësia Fatime i dtl. 06.05.1972, lindur në temeqinë Kosovë dhe banues në Prishtinë Kosovë , mbajtës i id kosovare me nr 1014063, **zotëruar i vlerës prej 90 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë**

Z. ARJAN MELONASHI , atësia Elise, amësia Afërdita, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Ali Demi; Nd. 157; H. 1; Ap. 3; Njësia Administrative Nr. 1; Tiranë 1; 0000; Tiranë, lindur më 29/07/1961, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031707717 dhe nr. personal G10729017G,  
**zotërues i vlerës prej 10 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë**

#### Neni 9

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkeshortëve. Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkeshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve e pasardhësve.

Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'iu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, vetëm me miratimin e shumicës së ortakeve që përfaqësojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

Projekti i transferimit i njoftohet Shoqërisë dhe secilit prej ortakeve.

Në rast se Shoqëria nuk e ka bërë të ditur vendimin e saj, brenda tre muajve nga data e njoftimit të fundit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë.

Në rast se Shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit, ortaket, brenda tre muajve nga data e këtij refuzimi, duhet të blejnë apo të lejojnë blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vertetohen me një akt noterial.

#### Neni 10

#### ASAMBLEJA

Asambleja është organi sovran i Shoqërisë. Asambleja e Shoqërisë Tregtare "ORCHIDE TIRANA" shpk përbehet prej ortakeve të saj.

Ortaku drejton veprimtarinë e Shoqërisë duke u mbështetur në të drejtën e tij të pronësive vetjake mbi mjetet e investuara në Shoqëri.

Asambleja mund të thirret nga një ose disa ortake që përfaqësojnë të paktën 5% të pjesëve të kapitalit themeltar.

Ortaket lajmërohen me leter rekomande të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së Asamblese në të cilën njoftohet rendi i ditës. Lajmerimi bëhet nga Administratori.

Administratori i shoqërisë është Z. NAIM NISHORI i cili zgjidhet çdo 5 vjet.

Vendimet e marra nga Asambleja në përputhje me këtë Statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi, janë të detyrueshme për ortaket e Shoqërisë. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zoteron.

Vendimet e Asamblese mund të merren edhe pas konsultimit me shkrim, në rast se të gjithë ortaket miratojnë me shkrim përmbajtjen e konsultimit.

Për çdo ceshtje të shqyrtuar nga ortaket mbahet procesverbal në një regjister të vecantë. Vendimet e Asamblese formulohen dhe firmosen nga Administratori i Shoqërisë.

Asambleja zhvillon mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Asambleja e zakonshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 3 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.

Në mbledhje të jashtëzakonshme shqyrtohen dhe vendoset për probleme që kanë të bëjnë me ndryshimet në Statutin e Shoqërisë, mbi venien e Shoqërisë në likuidim dhe emerimin e likuiduesve, si dhe për probleme të tjera për të cilat kërkohet miratimi i tyre me më tepër se tre të katërtat e kapitalit të Shoqërisë.

Në mbledhjet e Asamblese së zakonshme ose në konsultimet me shkrim vendimet merren nga një ose disa ortake që përfaqësojnë më shumë se 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar. Në rast se nuk sigurohet kjo shumicë, ortaket thirren ose konsultohen për herë të dytë dhe vendimet merren me shumicën e votave të dhëna pavarësisht nga përqindja e kapitalit që ato përfaqësojnë.

#### Neni 11

Secili ortak qe ka te drejten e pjesemarrjes ne Asamble mund te perfaqsohet ne te edhe nga nje person tjetër i autorizuar me shkrim nga ortaku i Shoqerise.

Nje ortak mund te perfaqsohet nga nje ortak tjetër.

Nje ortak nuk mund te ngarkoje nje mandatmbajtes te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit themeltar, duke votuar ai vete ne emer te pjeses tjetër te kapitalit themeltar.

#### Neni 12

Asambleja e Shoqerise Tregtare "ORCHIDE TIRANA" shpk drejtohet nga Administratori i saj Z. NAIM NISHORI per nje periudhe 5 vjecare me te drejten e riperseritjes.

#### Neni 13

##### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqeria Tregtare "ORCHIDE TIRANA" shpk deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi, vecanerisht dispozitat urdheruese e normative te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",

Shoqeria fiton personalitet juridik qe nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Biznesit, si person juridik, ndersa e ushtron aktivitetin ekonomik me regjistrimin si subjekt privat ne Zyren e Tatim - Taksave.

Emertimi i Shoqerise, kapitali themeltar dhe emri i Administratorit te saj duhet te figurojne ne te gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra prej shoqerise dhe qe u drejtohen te treteve.

#### Neni 14

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen Shoqeria Tregtare "ORCHIDE TIRANA" shpk. Ajo ka llogari te saj ne leke dhe valute ne bankat e Shqiperise.

#### Neni 15

Shoqeria Tregtare "ORCHIDE TIRANA" shpk vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime kontraktore dhe jashtekontraktore brenda kapitalit te saj.

Ortaket e Shoqerise perballojne humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

#### Neni 16

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve. Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratoreve edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve, kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratoreve e kalonte objektin e Shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

#### Neni 17


Administratori eshte pergjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

Asnje vendim i Asamblese nuk mund te ndaloje kerkese padine kunder administratorit per gabimet e kryera prej tyre gjate ushtrimit te detyres.

#### Neni 18

Administratori shkarkohet me vendim te ortakeve qe perfaqsojne me teper se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Ne rast se shkarkimi eshte bere pa arsye te drejte, ai le shkak per demshperblim financiar.

Perveç kesaj, administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit, me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.



#### Neni 19

Administratorit ose ortakeve qe nuk jane persona juridike nuk u lejohet te kontraktrojne ne cfaredolloj forme qofte, te marrin hua tek Shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj per paradhenie, si dhe te behen dorezanes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Kjo mase ndaluese zbatohet edhe ndaj perfaqsesve ligjore te ortakeve qe jane persona juridike.

Kjo mase zbatohet gjithashtu ndaj bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve te personave te cituar ne paragrafin e pare te ketij neni, si dhe ndaj cdo personi ndermjetes.

#### Neni 20

##### MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes ne Shoqerine Tregtare "ORCHIDE TIRANA" shpk rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtje qe nuk rregullohen me kontrate pune zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria merr persiper qe te respektojte rregullat e ligjet ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore per te gjitha te punesuarit ne Shoqeri, ndersa keta te fundit jane te detyruar te pranojne kete Statut te Shoqerise.

#### Neni 21

Te punesuarit ne Shoqeri pergjigjen sipas ligjit dhe sipas Statutit per moszbatimin e detyrave teaktuara, si dhe per demet qe ata i shkaktojne Shoqerise. Ata mbajne pergjegjesi penale dhe administrative per moszbatimin e detyrave te tyre.

#### Neni 22

Mosmarreveshjet e te punesuarëve me Shoqerine zgjidhen nga gjykata shqiptare. Kur pala ankuese eshte person i huaj, mosmarreveshja zgjidhet nga organi i percaktuar ne kontraten e punes.

#### Neni 23

Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit qe realizon Shoqeria, gjate ushtrimit te veprimtarise se saj ekonomike, nese ne kontraten e punes nuk eshte parashikuar ndryshe.

#### Neni 24

##### SEKRETI I PUNES

Te gjitha te punesuarit ne Shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se Shoqerise. Kjo detyre vazhdon edhe mbas largimit te tyre nga Shoqeria.

Detyrimi per ruajtjen e sekretit te punes se Shoqerise eshte e vlefshme edhe per Ortaket dhe Administratoret e Shoqerise.

#### Neni 25

##### PERFAQESIMI I SHOQERISE

Perfaqesimi i Shoqerise Tregtare "ORCHIDE TIRANA" shpk i perket administratorit te saj Z. NAIM NISHORI dhe/ose personave te autorizuar prej tij.

Neni 26

### KONTROLLI I BRENDSEHEM

Shoqeria organizon kontrollin e brendshem me ekspertet kontabel te autorizuar, i cili zgjidhet cdo 5 vjet nga Administratori i Shoqerise sipas dispozitave ligjore te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",

Neni 27

### BILANCI DHE TE ARDHURAT

Viti financiar i Shoqerise mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.

Ne mbylljen e cdo viti financiar, Administratori i Shoqerise ben inventarin dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat ligjore mbi kontabilitetin, si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin. Raporti i administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga Administratori, i nenshtrohen miratimit te Asamblese se Ortakeve brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 28

Shoqeria nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjet e vitit te meparshem, le menjane nje shume me vlere te pakten 1/20 e tij, e cila destinohet per formimin e nje fondi rezerve te quajtur "rezerve e domosdoshme".

Neni 29

Te ardhurat neto pas shlyerjes se detyrimeve fiskale dhe atyre ndaj te treteve, ndahen midis ortakeve te Shoqerise ne perputhje me kuotat e secilit ne formimin e kapitalit themeltar te Shoqerise.

Fitimi qe do te shperndahet, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven dhe nga ana tjeter, jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e bartura nga vitet e meparshme.

Asambleja mund te marre vendim qe te shperndahen shumat e lena menjane per rezerven qe ajo disponon. Ne kete rast vendimi tregon shprehimisht llojet e rezerves ku jane marre keto shuma.

Neni 30

Ne seline e Shoqerise mbahet dokumentacion i plote i saj, dokument themeluese te Shoqerise, si dhe dokumentet qe rregullojne marredheniet ekonomike te Shoqerise, me te gjitha ndryshimet e bera deri ne ditet e fundit.

Neni 31

### PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Prishja e Shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, si ne rast falimentimi, privimim i te drejtave re te ushtuar profesionin tregtar, forca madhore dhe cdo faktor tjeter qe nuk varet nga vullneti i Ortakeve te Shoqerise., por gjithmone me vendim te mbledhjes se jashtezakonshme te Asamblese se Ortakeve te shoqerise si dhe ne baze te ligjes.

Ne keto raste Asambleja vendos mbi menyren e likuidimit te Shoqerise, duke caktuar nje ose me shume likuidatore, me pelqimin e shumices per nga kapitali te ortakeve dhe percakton detyrat e tyre.

Ne rast likuidimi te Shoqerise, emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "Shoqeri ne likuidim e siper".


Ky shenim dhe emri i likuidusit ose i likuiduesve duhet te figurojne ne te gjitha aktet e dokumentat e nxjerra nga shoqeria dhe qe u drejtohen te treteve.

Likuidatoret dhe administratoret jane pergjegjes per veprimet e tyre dhe likuidimin e Shoqerise. Ata kujdesen per te likuiduar ne rradhe te pare detyrimet e Shoqerise ndaj te treteve.

Ndarja e kapitaleve te veta, qe mbeten pas pagimit te kreditorëve dhe te pjeseve te kapitalit themeltar, behet ndermjet ortakeve, ne perpjestim te njejte me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar.

Ortaket thirren ne fund te procesit te likuidimit qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullueshmerise per administrimin nga ana e likuiduesit dhe per heqjen e mandatit te tij si likuidues si dhe per te evidencuar mbylljen e likuidimit.

Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likuidimit dhe kryhen formalitetet e nevojshme te likuidimit, Shoqeria c' regjistrohet.



Neni 32

#### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut i referohet plotesimeve nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, si dhe dispozitave te legjislacionit shqiptar.

Neni 33

Cdo ndryshim e plotesim i Statutit te Shoqerise nuk prek personalitetin juridik te Shoqerise tregtare "ORCHIDE TIRANA" shpk.

Neni 34

Ky statut perpilohet ne kater kopje per:

- Qendren Kombetare te Regjistrimit i cili do te depozitohet nga Noterja ose persona të autorizuar prej saj.
- Zyren e Tatim - Taksave per marrjen e lejes se ushtrimit te veprimtarise
- Dhomen e Noterise
- nje kopje mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te Shoqerise tregtare ,

#### ORTAKE THEMELUES TE SHOQERISE TREGTARE "ORCHIDE TIRANA" shpk.

Z. NAIM NISHORI

Naim Nishori

Z. ARJAN MELONASHI

Arjan Melonashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER GENTJANA BRATI



V2021053840169633354

DATE 07/10/2021  
NR REP 2531



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 07.10.2021 para meje Notere GENTJANA BRATI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR.7, RRUGA GJERGJ FISHTA, GODINA NR.9, AP. NR. 1, HYRJA NR.1, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES/IT:**

Z. NAIM NISHORI atësia Milaim dhe amësia Fatime i dtl. 06.05.1972, lindur dhe banues në Kosovë , mbajtës i id kosovare me nr 1014063, **zotërues i vlerës prej 90 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë "ORCHIDE TIRANA"** shpk.

Arjan Melonashi, atësia Elise, amësia Afërdita, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Ali Demi; Nd. 157; H. 1; Ap. 3; Njësia Administrative Nr. 1; Tiranë 1; 0000; Tiranë, lindur më 29/07/1961, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031707717 dhe nr. personal G10729017G zoterues i vleres prej 10 % te kuotave te shoqerise "ORCHIDE TIRANA" shpk.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statutin e shoqerise ", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

GENTJANA BRATI